

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7133
E martë, 5 mars 2024
Çmimi 0.50 €

Rruga Prishtinë - Mitrovicë
po bëhet realitet,
thonë Kurti dhe Aliu



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

HAPET BAZA E NATO-S NË KUÇOVË, ULEN DY AVIONËT E PARË

FAQE 4-5



Në Kuçovë të Shqipërisë të hënën është përfunduar baza ajrore taktike e Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior (NATO), e para bazë e aleancës në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Në ceremoninë inauguruese morën pjesë përfaqësues të NATO-s, ministri i Mbrojtjes i Turqisë dhe ai i Italisë, përfaqësues të Ambasadës Amerikane në Tiranë dhe ata të

institucioneve të Shqipërisë dhe të Kosovës. Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka theksuar se kjo bazë është një element tjetër i sigurisë për rajonin e Ballkanit Perëndimor

OPINION

KOSOVA NË INTERPOL ËSHTË
DOMOSDOSHMËRI

F. 7

Burim
RAMADANI



AKTUALE



JASHARAJ: DITA E MËSUESIT
PO NA GJEN ME SFIDA, PAKËNAQËSI
DHE SHUMË HALLE

F. 6

PËRPARIM RAMA: JEMI
GATI PËR FORMIMIN E POLICISË
SË KRYEQYTETIT

F. 5

EKONOMI



BQK-ja ME ANË TË SMS-ve
I INFORMON QYTETARËT PËR QASJEN
NË LLOGARI BANKARE DHE PRANIMIN
E MJETEVE NË EURO

F. 8

STANDARDI I JETESËS, EKSPERTËT:
SHQIPËRIA MUND TË RRIETET MË
SHUMË EKONOMIKISHT

F. 8

SPORT



KOSOVA U18, PAS KUALIFIKIMIT
HISTORIK, KA SYNIME TË MËDHA
NË BOTËTOR

F. 10

ZGJERIMI
I BE-së PËR
BALLKANIN
PERËNDIMOR:
KOHA PËR
PËRPARIM
ËSHTË TANI!



IKD, FOL DHE
INPO: KPK-JA TË
SHPLLË SA MË
PARË KONKURSION
E RI PËR
KRYEPROKUROR
TË SHTETIT

F. 7



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Hapet baza e NATO-s në Kuçovë, ulen dy avionët e parë

Në Kuçovë të Shqipërisë të hënën është përruar baza ajrore taktike e Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior (NATO), e para bazë e aleancës në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Në ceremoninë inauguruese morën pjesë përfaqësues të NATO-s, ministri i Mbrojtjes i Turqisë dhe ai i Italisë, përfaqësues të Ambasadës Amerikane në Tiranë dhe ata të institucioneve të Shqipërisë dhe të Kosovës. Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka theksuar se kjo bazë është një element tjetër i sigurisë për rajonin e Ballkanit Perëndimor

EPOKA ERE **Faton DËRMAKU**

Prishtinë, 4 mars - Në Kuçovë të Shqipërisë më 4 mars është përruar baza ajrore taktike e Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior (NATO), e para bazë e aleancës në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Ministri i Mbrojtjes i Shqipërisë, Niko Peleshi, tha se baza në Kuçovë do të jetë një pikë strategjike për mbrojtjen e paqes dhe operacioneve të NATO-s. "Gjithçka pritët nga fronti i lindjes. Dhe ne duhet të jemi të përgatitur të mbrohemi

shqiptare përzgjedhja e bazës së Kuçovës lidhet sa me pozicionin gjeostrategjik të vendit, si dhe të vet aeroportit, aq dhe me besueshmërinë që Shqipëria ka krijuar në gjirin e aleancës ushtarake.

Në ceremoninë inauguruese morën pjesë përfaqësues të NATO-s, ministri i Mbrojtjes i Turqisë dhe ai i Italisë, përfaqësues të Ambasadës Amerikane në Tiranë dhe ata të institucioneve të Shqipërisë dhe të Kosovës. "Kjo bazë do të luajë një rol të rëndësishëm për t'iu përgjigjur kërcënimeve që vijnë nga kufiri lindor dhe jugor



"I cili e dimë mirë se është një rajon jo i parrezikuar nga kërcënimi dhe ambicet neoimperialiste të Federatës Ruse". "Riaktivizimi i këtij aeroporti ushtarak është njëkohësisht edhe pjesë e

Shqipëria është më e gatshme se kurrë që të marrë përgjegjësi për ta mbrojtur sigurinë dhe paqen.

I dërguari i Shteteve të Bashkuara, David Wisner, e konsideroi bazën në Kuçovë

Kosova i gëzohet hapjes së bazës së NATO-s në Kuçovë

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se hapja e bazës ajrore të NATO-s në Kuçovë shënon një hap të rëndësishëm për forcimin e pranisë së Aleancës në Ballkanin Perëndimor. "Hapja e Bazës Taktike Ajrore të NATO-s në Kuçovë, Shqipëri, shënon një hap të rëndësishëm në forcimin e pranisë së Aleancës në Ballkanin Perëndimor, duke kontribuar në rritjen e sigurisë në rajonin tonë dhe më gjerë. Ku ka NATO, ka paqe dhe stabilitet!", ka shkruar Osmani në "X".

Edhe lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se baza ajrore e NATO-s në Kuçovë të Shqipërisë, që është hapur të hënën, është bazë e sigurisë rajonale të Ballkanit. "Sa më afër NATO-s, jemi më të lirë e më të sigurt, por anëtarësimi i plotë i Kosovës në këtë Aleancë, sigurinë do ta bënte më të plotë. E përgëzoj Shqipërinë për rreshtimin e saj të natyreshëm në këtë Aleancë, por nuk mund të mos shprehë inordinatën time të thellë për qeverinë e Albin Kurtit, e cila po e turpëron Kosovën duke dalë nga kontrata politike me udhëheqësit e NATO-s", ka thënë Haradinaj.



me të vetmen formulë fituese në tavolinë: bashkimin e forcave dhe kapaciteteve tona mbrojtëse", ka theksuar Peleshi. Ai, po ashtu, shprehu gatishmërinë e Shqipërisë, shtetit anëtar të NATO-s, që të vë në dispozicion të aleancës ushtarake perëndimore edhe portin në Durrës, Porto Romano që, siç tha Peleshi, së bashku me "Korridorin 8", që lidh Shqipërinë përmes rrugëve tokësore dhe hekurudhore me Maqedoninë e Veriut dhe Bullgarinë, i siguron aleancës aksin më të shkurtër të kalimit nga brigjet e Detit Adriatik në Detin e Zi. Punimet për rikonstruksionin e bazës në Kuçovë nisën në janar të vitit 2022.

Nga NATO janë investuar afërsisht 50 milionë euro dhe më shumë se 5 milionë euro janë investuar nga qeveria shqiptare. Për autoritetet

i Aleancës, njëkohësisht edhe rritjes së aftësive tona të mbrojtjes kolektive, duke promovuar ndërveprimin midis forcave aleate dhe duke mundësuar një përgjigje të shpejtë dhe efektive ndaj çdo sfide që mund të lindë. Gjithashtu, baza ajrore në Kuçovë, e vetmja e këtij lloji në Ballkanin Perëndimor, do të kontribuojë në mundësimin e planit rajonal jugor-lindor për mbështetjen e operacioneve dhe stërvitjeve të Aleancës, patrullimin e hapësirës ajrore, mbështetjen logjistike si kapacitet i vendit pritës apo edhe për qëllime e situata të tjera", ka shpjeguar gjatë fjalës së tij shefi i Shtabit të Përgjithshëm të ushtrisë shqiptare, gjeneralmajor Arben Kingji.

Kryeministri Edi Rama ka theksuar se kjo bazë është një element tjetër i sigurisë për rajonin e Ballkanit Perëndimor.



ri-përtëritjes dhe rritjes së mëtejshme cilësore të flotës sonë ajrore. Dy helikopterët e rinj Black Hawk si dhe dronët Bayraktar janë pjesë e një rritjeje që do të vazhdojë", ka theksuar Rama. Ai tha se po punohet me aleancën që sa më shpejt të bëhet gati edhe baza e re detare e NATO-s në Porto Romano. Ndërkaq, sipas presidentit të Shqipërisë, Bajram Begaj, në situatën globale, që ai tha se është e paqëndrueshme, vendi duhet të jetë i gatshëm ta mbrojë veten dhe të kontribuojë për aleancën. "Baza e Kuçovës ka një mision mbrojtës dhe shkurajues, një qendër e rëndësishme për operacionet e NATO-s për t'iu përballuar kërcënimeve e sotme dhe të nesërme", ka pohuar presidenti Begaj.

Përfaqësuesi i NATO-s, gjenerali Juan Pablo Sanchez De Lara, gjatë ceremonisë tha se

"arritje të madhe për sigurinë e rajonit".

Përrimin e kësaj baze e mirëpriti edhe presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, e cila tha se kjo bazë e NATO-s do të kontribuojë në rritjen e sigurisë në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Baza ajrore e Kuçovës është ndërtuar në vitet 1950.

Pak ditë para inaugurimit në këtë bazë u dërguan edhe tre dronë Bayraktarë të cilët Shqipëria i ka blerë nga Turqia. Në fund të ceremonisë, dy helikopterët Black Hawk, dronët Bayraktarë dhe gjashtë avionët Eurofighter F-2000 fluturuan mbi qiellin e Kuçovës, ndërsa dy Eurofighater italianë ishin të parët avionë të NATO-s që u ulën në pistën e saj.

Hapësira ajrore e Shqipërisë, që kufizohet me Greqinë në jug dhe Malin e Zi në veri, mbrohet nga Italia dhe Greqia.

Edita Tahiri i shkruan letrën e dytë Guterresit, kërkon drejtësi ndërkombëtare për gratë e mbijetuara nga përdhunimet seksuale gjatë luftërave në Kosovë, Bosnjë dhe Kroaci

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHINË, 4 MARS - Edita Tahiri, në cilësinë e kryetares së Lobit Rajonal të Grave në Evropën Juglindore (RWLSEE), ia ka dërguar letrën e dytë sekretarit të përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, Antonio Guterres, nga i cili ka kërkuar drejtësi ndërkombëtare për gratë e mbijetuara nga përdhunimet seksuale gjatë luftërave në Kosovë, Bosnjë-Hercegovinë dhe Kroaci. "Letra e Dytë drejtuar Shkëlqesisë së Tij Z. Antonio Guterres përmes së cilës kërkohet drejtësia ndërkombëtare për gratë e mbijetuara nga përdhunimet seksuale gjatë luftërave në Kosovë, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Kroaci. Shkëlqesia Juaj, kjo letër është për t'ju kërkuar edhe një herë me dashamirësi që të adresoni çështjen e drejtësisë ndërkombëtare për gratë e mbijetuara nga përdhunimet seksuale gjatë konflikteve në Kosovë, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Kroaci, që është një përvojë shumë tragjike dhe e dhimbshme e grave në rajonin tonë të Ballkanit Perëndimor, që nga koha e luftërave të shpërbërjes së ish-Jugosllavisë. Edhe 20 vite pas përfundimit të luftërave, gratë viktime përjetojnë këtë plagë lufte, ndërsa autorët janë të pandëshkuar. Ky realitet është me shqetësim të madh, sepse drejtësia ndërkombëtare nuk është vendosur, ndërkohë që dukuritë e dhunës seksuale si armë lufte në luftërat e vazhdueshme, duke pasur parasysh konfliktet e armatosura janë rritur me ritme alarmante vitet e fundit. Ne besojmë fuqishëm në drejtësinë si e vetmja mënyrë për të shëruar plagët e luftërave dhe për të arritur pajtimin. Ne gjithashtu besojmë se është OKB-ja ajo që ka autoritetin ligjor për të ofruar drejtësi, bazuar në të drejtën ndërkombëtare, konventat, rezolutat e KS të KS-së, veçanërisht Rezoluta 2106 (2013) të KS-së të OKB-së. Megjithatë, nuk ka ende drejtësi ndërkombëtare për gratë e mbijetuara të dhunës seksuale të



lidhur me konfliktin dhe as mekanizmi nuk ekziston për të adresuar këtë çështje", shkruan Tahiri në këtë letër. Lidhur me këtë çështje, Tahiri ka treguar edhe për një takim që ka pasur më 14 mars në vitin 2019 me Pramila Patten në selinë e OKB-së. "Më 14 mars 2019, u takova me Pramila Patten në zyrën e saj në selinë e OKB-së në cilësinë time si Kryetare e Lobit Rajonal të Grave në Evropën Juglindore (RWLSEE). Unë isha e shoqëruar nga Alia El Yassir, Drejtoresha e UN Women për Evropën dhe Azinë Qendrore. Në takim u diskutua gjerësisht për çështjen e përdhunimit seksual gjatë luftërave në Kosovë, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Kroaci si dhe për kërkesën tonë për drejtësi ndërkombëtare për gratë e mbijetuara të dhunës seksuale të lidhur me konfliktin në këto tre vende të Ballkanit Perëndimor. Në

atë takim, unë dorëzoja dy letra drejtuar juve si Sekretar i Përgjithshëm i OKB-së. Letra e parë drejtuar jush nga RWLSEE duke kërkuar drejtësi ndërkombëtare për gratë e mbijetuara të dhunës seksuale të lidhur me konfliktin në Kosovë, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Kroaci. Po ashtu, kam dorëzuar edhe peticionin e qytetarëve të Kosovës (me 100.000 nënshkrime) drejtuar juve, duke kërkuar drejtësi ndërkombëtare për gratë e mbijetuara të dhunës seksuale të lidhur me konfliktin në Kosovë. (versioni elektronik i peticionit) së bashku me letrën drejtuar jush nga Bordi i Grave të Kosovës për Peticion, ku unë jam udhëheqëse dhe nismëtare e këtij peticioni. (të bashkangjitura janë dy letrat e dorëzuara zonjës Patten për t'ju dorëzuar juve). Megjithatë, asnjëherë nuk kemi marrë përgjigjen tuaj dhe nuk janë

ndërmarrë hapa konkretë për ta adresuar këtë çështje", ka theksuar Edita Tahiri. Ajo ka thënë se pas konflikteve në Kosovë, Bosnjë-Hercegovinë dhe Kroaci, dhjetëra mijëra gra janë përdhunuar dhe abuzuar gjatë luftërave në këto vende në kuadër të shpërbërjes së ish-Jugosllavisë. "Në luftën e Bosnjës (1992-1995), vlerësohet se numri i grave të mbijetuara të dhunës seksuale sillet diku në mes 12,000 dhe 50,000. Në luftën e Kosovës (1998-1999), vlerësohet se numri i grave të mbijetuara të dhunës seksuale është mbi 20,000. Në luftën e Kroacisë (1991-1995), vlerësohet se numri i grave të mbijetuara të dhunës seksuale është mbi 2,200. Megjithëse kjo dukuri tmerruese renditet në mesin e mizorive më të rënda në historinë moderne të Evropës, vazhdon të mbetet një gjenocid i fshehur deri në ditët e

sotme", ka shkruar Tahiri në këtë letër. Ndër të tjera, ajo ka shkruar në letrën drejtuar Guterresit se rezoluta 2106 (2013) e KS të OKB-së mbështet plotësisht parimin e sigurimit të shërbimeve duke përfshirë drejtësinë për të mbijetuarat dhe përfundimin e mosndëshkimit. "Prandaj, ne ju bëjmë thirrje që të bëni çmos për të zbatuar drejtësinë ndërkombëtare për gratë e mbijetuara të dhunës seksuale të lidhur me konfliktin, duke siguruar që krime të tilla kundër njerëzimit nuk do të ndodhin më kurrë. Ne besojmë në udhëheqjen tuaj dhe përkushtimin ndaj drejtësisë! Ne mezi presim angazhimin tuaj në adresimin pozitiv të kësaj çështjeje të rëndësishme për gratë e mbijetuara dhe për një të ardhme të drejtë dhe paqësore në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe më gjerë", thuhet në letrën e Tahirit.

BE-ja dhe dhjetëra vende bëjnë thirrje për hetimin e vdekjes së Navalnyt



BRUKSEL, 4 MARS - Më shumë se 40 vende i kanë përsëritur thirrjet të hënën për Rusinë që ta lejojë një hetim të pavarur ndërkombëtar për vdekjen e liderit opozitar rus në burg, Alexei Navalny. Kjo thirrje u bë nga ambasadorja e Bashkimit Evropian (BE) në Këshillin e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut në Gjenevë, Lotte Knudsen, në emër të 27 vendeve anëtare të BE-së dhe 16 vendeve të tjera, përfshirë Kanadanë,

Britaninë e Madhe, Shtetet e Bashkuara dhe Ukrainën. "Ne jemi të zemëruar me vdekjen e politikanit rus Alexei Navalny, për të cilën përgjegjësinë kryesore e kanë presidenti [Vladimir] Putin dhe autoritetet ruse", tha Knudsen. "Rusia duhet patjetër të lejojë hetim të pavarur dhe transparent ndërkombëtar të rrethanave të vdekjes së tij të papritur", shtoi ajo. Navalny, kritiku më i madh dhe i zëshëm i presidentit

Putin brenda Rusisë, vdiq në moshën 47-vjeçare në një burg në Arktik më 16 shkurt, duke nxitur akuza nga mbështetësit e tij se ai është vrarë. Kremli e ka mohuar se ka gisht në vdekjen e liderit opozitar, i cili u varros të premten në Moskë. Komiteti Hetues i Rusisë thotë se e ka nisur një hetim procedural për vdekjen e Navalnyt, ndërsa Kremli ka thënë se nuk u përgjigjet kërkesave të BE-së.



NË PRISHTINË MBAHET KONFERENCA “URËZIMI I BALLKANIT PERËNDIMOR: DIPLOMACIA PARLAMENTARE PËR SIGURINË RAJONALE DHE INTEGRIMIN EUROATLANTIK”

Zgjerimi i BE-së për Ballkanin Perëndimor: Koha për përparim është tani!

Të hënën, për herë të parë në Kosovë, Komisioni për Punë të Jashtme dhe Diasporë, me mbështetje të organizatës Friedrich-Ebert-Stiftung Kosovo Office (FES), ka organizuar konferencën “Urëzimi i Ballkanit Perëndimor: diplomacia parlamentare për sigurinë rajonale dhe integrimin euroatlantik”. Në të morën pjesë kryeparlamentari Glauk Konjufca, kryeministri Albin Kurti, deputetë të Kuvendit të Kosovës, diplomatë të huaj dhe përfaqësues nga shoqëria civile. Në këtë konferencë u tha se anëtarësimi në Bashkimin Evropian dhe bashkëpunimi rajonal është shumë me rëndësi, por kjo kërkon një numër të madh reformash në vendet e rajonit

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 4 MARS - Organizuar nga Komisioni për Punë të Jashtme dhe Diasporë dhe me mbështetje të organizatës Friedrich-Ebert-Stiftung (FES), ka filluar të hënën në Prishtinë konferenca “Urëzimi i Ballkanit Perëndimor: diplomacia parlamentare për sigurinë rajonale dhe integrimin euroatlantik”. Në këtë konferencë morën pjesë kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, kryeministri Albin Kurti, deputetë të Kuvendit të Kosovës, diplomatë të huaj, përfaqësues nga shoqëria civile

etj.

Kryetarja e Komisionit për Punë të Jashtme dhe Diasporë, Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, në cilësi të nikoqires, gjatë ceremonisë së hapjes ka theksuar se në këtë konferencë, e cila po organizohet për herë të parë në Kosovë, do të diskutohet për Ballkanin Perëndimor dhe për zgjerimin e Bashkimit Evropian, por edhe për tema të tjera që lidhen me bashkëpunimin dhe zhvillimin e demokracisë. “Po ashtu, do të diskutohet për sigurinë në një kohë kur konfliktet janë aktuale në disa vende të botës, për rolin dhe

ndikimin e shoqërisë civile dhe medieve në demokratizimin e shoqërisë sonë dhe të ardhmen, që sigurisht është synim i të gjithëve, një përpjekje që të kemi një të ardhme sa më të ndritur për vendin tonë”, ka thënë Kryeziu-Hyseni.

Kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, ka thënë se diplomacia

parlamentare është një nga mjetet më të fuqishme për të ndërtuar marrëdhënie bilaterale dhe bashkëpunim të qëndrueshëm.

“Diplomaci parlamentare për ne do të thotë forcim i miqësive me parlamentet e vendeve mike, por edhe krijimi i miqësive të reja me deputetë dhe përfaqësues të vendeve që

ende s’e kanë njohur Kosovën”, është shprehur Konjufca. Sipas tij, edhe vetë shtetësia e Republikës së Kosovës ka kaluar nëpër procese diplomatike. “Vetëkrijimi i shtetit të Kosovës ka marrë shumë përpjekje diplomatike dhe ka kaluar në shumë faza të trajtimit diplomatik”, ka thënë Konjufca.



Kreu i legjislativit përmendi disa institucione të rëndësishme evropiane, pjesë e së cilave është Kuvendi i Kosovës, ndërsa shtoi se po punohet për forcim të bashkëpunimit diplomatik. "Jemi pjesë e Këshillit të Evropës. Kuvendi e ka një delegacion atje, i cili vërtet bën një punë të mirë. Jemi pjesë e Asamblesë Parlamentare të NATO-s, e Asamblesë Parlamentare për Procesin e bashkëpunimit të Evropës Juglindore, po ashtu edhe pjesë e Frankofonisë dhe shumë trupave të rëndësishëm në botë, në të cilët Kosova jep kontributin nëpërmjet pranisë së përfaqësuesve të saj", ka deklaruar kryeparlamentari Konjufca.

Kryeministri Albin Kurti ka thënë se diplomacia parlamentare është e rëndësishme për ta ndihmuar Evropën në navigimin e kompleksiteteteve dhe përballjen me narrativat e vjetra. "Ka ende historikisht dallime politike dhe pabarazi socio-ekonomike të cilat kërcënojnë të na ndajnë në vend që të bashkohen. Kjo është arsyeja pse duhet t'i promovojmë principet e dialogut dhe gjithëpërfshirjes, të cilat janë esenciale për të krijuar ura ndërmjet njerëzve dhe shteteve", ka pohuar kryeministri Kurti. Sipas tij, në rajonin e Ballkanit Perëndimor shihet se si regjimi në Serbi është nxitur nga pushtimi i Ukrainës nga ana e Ruisë.

Kreu i qeverisë tha se në dy vitet e para të qeverisjes Serbia ka sjellë katër herë ushtrinë te kufiri, ka sponsorizuar terrorizmin, ka shpërndarë gënjeshtër dhe narrativa të rrejshme për t'i përligjur veprat e saj ndaj Kosovës dhe rajonit. "Kërcënimet e sigurisë në Ballkanin Perëndimor nga Serbia duhet të trajtohen duke përdorur të njëjtën qasje, pra duke i dhënë Kosovës statusin e vendit kandidat për Bashkimin Evropian dhe anëtarësimin në Këshillin e Evropës", është shprehur Kurti, duke shtuar se



mungesa e përparimit në anëtarësimin e Kosovës në BE dhe Këshillin e Evropës nuk kanë të bëjnë me mungesën e demokracisë dhe mbrojtjes së fortë të të drejtave të minoriteteve dhe të drejtave të njeriut, por në sjelljen e një regjimi autoritar sepse Serbia nuk është e interesuar për anëtarësim në NATO apo BE. Ajo kërkon ta bllokojë përparimin e gjithë rajonit, duke frenuar të gjithë rajonin", ka pohuar Kurti.

Drejtori i Friedrich-Ebert-Stiftung për Kosovë, Peter Hurrelbrink, ka thënë se anëtarësimi në Bashkimin Evropian dhe bashkëpunimi rajonal është shumë me rëndësi, por kjo kërkon një numër të madh reformash në vendet e rajonit. "Është e rëndësishme të diskutohet për sfidat në siguri, luftimin e krimit dhe korrupsionit, përfshirjen e shoqërisë civile dhe medieve në rolin primar dhe shumë reforma të tjera që duhet të bëhen për ta përmirësuar jetën e qytetarëve", ka thënë Hurrelbrink.

Konferenca ka vazhduar punimet

edhe me panelistë të tjerë.

Nën moderimin e Gent Carrabregut, profesor asistent në RIT Kosova, konferenca e mirëpriti panelin e parë diskutues, në përbërje Lukas Mandi, deputet i Parlamentit Evropian, njëherësh kryetar i Shoqatës së Miqësisë Austriako-Kosovare, Fitore Pacolli Dalipi, deputete dhe anëtare e Komisionit për Punë të jashtme, Ditmir Bushati, ish-ministër i Punëve të Jashtme i Shqipërisë, Alejandro Esteso Perez, analist politik i specializuar për Ballkanin Perëndimor/Zgjerimi i BE-së, si dhe Jeton Zulfaj, këshilltar politik i kryeministrit të Republikës së Kosovës.

Diskutimi u përqendrua në arsyen strategjike të zgjerimit të Bashkimit Evropian për t'i inkorporuar vendet e Ballkanit Perëndimor si dhe për të shqyrtuar se si përfshirja përputhet me interesat më të gjera strategjike të BE-së, duke përfshirë stabilitetin, sigurinë dhe rritjen ekonomike.

Panelistët fillimisht falënderuan kryeministrin dhe kryetarin e

Kuvendit për qëndrimin dhe dëgjimin aktiv të tyre në Konferencë ngaqë, siç thanë ata, një veprim i tillë nuk ndodh të shihet shpesh dhe se kjo është një sjellje dhe praktikë e mirë që duhet të shërbejë si shembull edhe për konferencat e tjera.

Më tutje, panelistët ofruan këndvështrimet tyre, të cilat në aspektin e përgjithshëm mirëpritën kandidimin e Gjeorgjisë, Ukrainës dhe Moldavisë për statusin e kandidatit për anëtarësim në Bashkimin Evropian, përderisa potencuan të mirat dhe përfitimet që i sjell ky rrjetëzim, zgjerim për vendet e rajonit.

U tha se Kosova ka shënuar përparim në sundim të ligjit, fuqizim të institucioneve në shtetin e së drejtës dhe reforma të tjera konform agjendës evropiane. U potencua se rrugëtimi për në BE shihet me shumë seriozitet, por që nga ana tjetër Kosova po vazhdon të penalizohet për shkak të Serbisë, e cila, përveç që nuk po shënon përparim kah e ardhmja, po pengon edhe shtetet e tjera në

procesin e zhvillimit. Andaj u potencua nevoja për trajtim të barabartë, bazuar në meritokraci. Pastaj u vu në pah se pikërisht lufta në Ukrainë e ka bërë të qartë se kur kemi të bëjmë me sfida, BE-ja mund të ndikojë pozitivisht në ndryshim, sikurse i vendosi sanksione Ruisë pas aneksimit të Ukrainës. Duke marrë parasysh këtë situatë, u tha se BE-ja duhet të tregohet më e qartë dhe vendimmarrëse kur shtrihet çështja Kosovë - Serbi sepse, siç u potencua, duket sikur është krijuar një mit që disa vende me udhëheqës autokratë sikurse Serbia, po trajtohen barabartë, madje edhe favorizohen kundrejt Kosovës me liderë me qëllime progresive.

Qasje më optimiste tregoi Mandi nga Parlamenti Evropian, i cili potencoi që vetë emërtimi i konferencës është pozitiv dhe duhet të shihet nga perspektiva pozitive e ndërtimit të marrëdhënieve, urave të bashkëpunimit ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor në tejkalimin e sfidave dhe të shkuarës. Ai rekomandoi që shteti ynë t'i rregullojë punët e brendshme, hapje të vendeve të reja të punës, duke krijuar kështu një atmosferë të shtetit të së drejtës, ndërsa kritikoi qasjen e Serbisë, duke thënë se me qasjen e saj po e dëmton popullin e saj dhe se e ardhmja i përket bashkëpunimit e unitetit e jo përçarjes e ndasisë.

Punimet vazhduan me pyetje nga audiencia lidhur me konkretizimin e strategjisë diplomatike që do ta trasonte dhe ndihmonte rrugën e Kosovës për në BE, si dhe si të veprohet me vendet të cilat nuk janë të interesuara për zgjerim.

Deputeti Mandi tha që njerëzit në Kosovë duhet të kenë besim në vetë dhe në ndërtimin e aleancave me fqinjët, e sidomos të dëshmojnë se janë partner i besueshëm dhe t'i bëjnë ballë presionit që u bëhet ngaqë, siç tha ai, me gjithë presionin, vetë qytetarët janë përgjegjës për shtetin e tyre.

Përparim Rama: Jemi gati për formimin e policisë së kryeqytetit

PRISHTINË, 4 MARS - Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka bërë me dije se janë në përfundim të strukturimit të policisë së kryeqytetit. Në "Facebook" ai ka theksuar se për këtë ka takuar drejtorin e Policisë, Gazmend Hoxha, me të cilin e ka diskutuar mundësinë e realizimit të këtij projekti. "Jemi në rrugë të mbarë për t'i finalizuar procedurat për strukturimin e policisë së kryeqytetit, një hap tepër i rëndësishëm për ta rritur sigurinë dhe mirëqenien në qytetin tonë. Sot, në një takim me udhëheqësit kryesorë të Policisë së Republikës së Kosovës, drejtorin e Përgjithshëm, Gazmend Hoxha, drejtorin e Policisë për Rajonin e Prishtinës, Basri Shabani dhe drejtorin e

Departamentit të Operacioneve në Polici, Arbnesh Ajvazin, diskutuam detajet për organizimin e drejtorisë së re e cila do të funksionojë në kuadër të Drejtorisë Rajonale të Policisë në Prishtinë. Gjatë takimit theksuam rëndësinë e bashkëpunimit të ngushtë mes Kryeqytetit dhe Policisë, veçanërisht për të adresuar sjelljet që dëmtojnë jetën publike, duke u fokusuar në intensifikimin e masave ndaj atyre që hedhin mbeturinat jashtë vendeve të caktuara dhe parkojnë mjetet e tyre duke penguar kompaninë 'Pastrimi' të kryejë shërbimin, dhe ndaj atyre që parkojnë makinat në mënyra që pengojnë qarkullimin dhe qetësinë publike", ka thënë Rama.



Jasharaj: Dita e mësuesit po na gjen me sfida, pakënaqësi e halle shumë

PRISHTINË, 4 MARS - Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, ka thënë se Dita e Mësuesit po na gjen me sfida dhe pakënaqësi e halle të shumta. “Në takimin me kryetarët e nivelit komunal sindikal e të universiteteve do të duhej të mbretëronte atmosferë festive dhe të flitej me krenari për angazhimet e qeverisë në shërbim të arsimit e punëtorëve arsimorë, që nga çerdhet e deri në universitet dhe për dialogun e sinqertë për të gjitha sfidat e shqetësimet. Por kjo atmosferë mungoi sepse dialogu me fajin e pushtetarëve vazhdon të mungojë. Ata vazhdojnë të sjellin vendime e të bëjnë veprime të dëmshme kokë me vete e pa u ulur e konsultuar me palët e tjera. Kështu do të bëhet

dhe pikë, vazhdojnë të deklarohen qeveritarët dhe ashtu bëjnë”, ka thënë Jasharaj. Ai ka treguar se SBASHK-u në emër të punëtorëve arsimorë ka kërkuar përmes shkresave që vlera e koeficientit të mos jetë ajo e paralajmëruar në vitin e kaluar nga ministri Murati, po të jetë se paku 130 euro. Por, sipas Jasharajt, qeveria nuk çau kokën për këtë kërkesë të tyre dhe të sindikatave të tjera, por vendosi për vlerën 110, duke bërë një ngritje ironike të pagës në arsim prej vetëm 28 eurosh. Kjo shtoi edhe më pakënaqësitë e të punësuarve në këtë sektor dhe jo vetëm. “Qeveria, pa u konsultuar me palët e tjera, vendosi edhe për ndryshimet në Ligjin për Skemat Pensionale të financuara



nga shteti dhe, si për inat, angazhohet t'i mohojë të drejtat e fituara të punëtorëve të arsimit dhe kështu, në vend se t'ua

lehtësojë jetën pak pikërisht kur u duhet, pra me rastin e pensionimit, qeveria ua vështirëson edhe më jetën atyre

që me vite e dekada punuan në arsim sepse do të marrin pensione më të ulëta nga ato që ua garantonte ligji dikur”, është shprehur Jasharaj.

Ai ka shtuar se qeveria nuk e bëri as Ligjin për Sigurime Shëndetësore, as nuk bëri ndonjë angazhim lidhur me kushtet e punës në shkollë. “Nxënësit dhe mësuesit garën për dije në shekullin 21 vazhdojnë ta bëjnë me shumës dhe shpuzë. Ata duan, por me këto kushte e me këtë qasje të qeverisë ndaj arsimit, suksese të larta e të dëshiruara nga të gjithë ne nuk mund të arrihen. Dita e mësuesit dhe shkollës shqipe po vjen, por ajo po na gjen me sfida, pakënaqësi dhe halle shumë”, ka theksuar Jasharaj.

Inaugurohet Qendra e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike të UP-së

PRISHTINË, 4 MARS - Inaugurimi i Qendrës së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike të Universitetit të Prishtinës ishte aktiviteti i radhës në të cilën mori pjesë të hënën kryeministri Albin Kurti, i cili u jetësua si rezultat i marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”.

Në fjalën e tij të rastit, kryeministri theksoi se hapja e kësaj qendre shënon një hap të rëndësishëm në angazhimin tonë për të nxitur një kulturë të inovacionit dhe ndërmarrësisë brenda komunitetit tonë akademik, në ekonominë e shoqërinë sonë në përgjithësi. “Qendra për Inovacion dhe Ndërmarrësi në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike do të shërbejë si nyje e rëndësishme e kreativitetit dhe e bashkëpunimit. Do të jetë një hapësirë ku inicohen idetë, ku sfidat përballen me zgjidhje inovative dhe ku kultivohet fryma e ndërmarrësisë. Kjo qendër jo vetëm që do ta avancojë përvojën mësimore të studentëve tanë, por do të kontribuojë në zhvillimin e ideve biznesore, teknologjive dhe



zgjidhjeve, të cilat i adresojnë problemet reale të industrisë dhe të ekonomisë”, shtoi ai.

Më tej, siç tha kryeministri, lansimi i kësaj qendre do ta mundësojë pajisjen e studentëve tanë me aftësitë, mendësitë dhe burimet e nevojshme për t'u ballafaquar me sfidat e botës moderne që po zhvillohen me shpejtësi marramendëse, derisa

stafi akademik i fakultetit do të ketë kushte më të mira për punë kërkimore dhe për të marrë pjesë me projekte në programet e BE-së si Horizon Europe e Digital Europe, në të cilat Kosova është anëtarësuar rishtas.

Ndërkaq ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, u shpreh e lumtur për inaugurimin e Qendrës së

Inovacionit dhe Ndërmarrësisë në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, të cilën e konsideroi hapësirë që do të krijojë një kulturë që mbështet inovacionin dhe nxit rritjen e ekosistemit të ndërmarrësisë, duke fuqizuar studentët, të diplomuarit, ndërmarrësit, inovatorët dhe ndërmarrësit potencialë si individët apo studentët, të cilët me

talentin dhe kreativitetin e tyre do të krijojnë ndërmarrje të reja inovative.

Si dëshmi e angazhimit për inovacion dhe ndërmarrësi, Qeveria e Republikës së Kosovës tashmë është duke investuar në dy platforma të tjera të rëndësishme: Parku i Inovacionit dhe Trajnimeve në Prizren - ITP, hapësirë prej 40 hektarësh si bashkëinvestim me qeverinë gjermane, që tashmë popullohet me mbi 40 kompani vendore dhe ndërkombëtare dhe pjesëmarrës të tjerë nga organizata joqeveritare e akademike; si dhe Tech Park Prishtina, hapësirë moderne në të cilën qeveria ka investuar 1.2 milion euro, dhe e cila i është dhënë për menaxhim Shoqatës së Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit - STIKK-ut si përfaqësues i sektorit privat të TIK-ut.

Pas fjalëve hyrëse u bë edhe prerja e shiritit, ndërkaq kryeministri me të pranishmit vizituan ambientet e kësaj qendre ku panë nga afër laboratorët në të cilët do të mbahen trajnime dhe orë praktike nga studentët. Po në këtë qendër do të kenë mundësinë të përfitojnë edhe biznese të ndryshme të interesuara.

“Sheikh Zayed” viziton Klinikën e Pediatriisë, shpërndan dhurata për 100 fëmijë

PRISHTINË, 4 MARS - Një delegacion i lartë nga Fondacioni “Sheikh Zayed” i Emirateve të Bashkuara Arabe, vizitoi Klinikën e Pediatriisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës. Delegacioni u prit nga zëvendësuesi i drejtorit të përgjithshëm të QKUK-së, Osman Hajdari, drejtoresha e Klinikës së Pediatriisë, dr. Violeta Uka, si dhe stafi i

kësaj klinike. Gjatë vizitës përfaqësuesit e këtij fondacioni shpërndanë dhurata (veshmbathje) për 100 fëmijë që marrin shërbime shëndetësore në Klinikën e Pediatriisë.

Në takim të pranishmit diskutuan për projektet të reja si dhe për ndihmën që mund të ofrojë shteti i Emirateve të Bashkuara Arabe për institucionin tonë.

Zëvendësuesi i drejtorit të përgjithshëm të QKUK-së, Osman Hajdari, i falënderoi të pranishmit për bashkëpunimin dhe ndihmën e vazhdueshme që i është bërë për rastet e shtrira në Klinikën e Pediatriisë, si dhe gatishmërinë për të ndihmuar edhe me tutje në infrastrukturë dhe nevoja të tjera, sipas kërkesës së Klinikës së Pediatriisë.



Kosova në INTERPOL është domosdoshmëri



Burim RAMADANI

Anëtarësimi i Kosovës në INTERPOL është jashtëzakonisht i rëndësishëm, jo vetëm për shkaqe të subjektivitetit ndërkombëtar të shtetit të Kosovës, por edhe për luftimin e drejtpërdrejt të Krimin të Organizuar Transnacional, terrorizmit, apo dukurive tjera negative të cilat e kërcënojnë jo vetëm

Kosovën, por edhe rajonin dhe globin.

Ajo që duket tepër e qartë është se mungon një qasje serioze e institucioneve të Kosovës për të ndërtuar një Strategji të mirëfilltë, Plan Veprimi të lobimit dhe diplomacisë në mënyrë që Kosova të merr mbështetjen e shteteve Perëndimore partnere dhe aleate për të fituar apo për të siguruar votat e mjaftueshme që Kosova të jetë anëtare e INTERPOL-it.

Qeveria e Kosovës duhet ta shfrytëzojë vitin 2024, Asambleja e Përgjithshme e INTERPOL do të mbahet në Glasgow dhe është jashtëzakonisht me rëndësi që Kosova të aplikojë dhe të llojë fuqishëm, të koordinohet me

partnerët dhe aleatët Perëndimorë.

Tash duket se përgatitjet dhe interesimi për anëtarësimin e Kosovës në INTERPOL janë zero. Pra, nuk kemi parë as interesim, as përpjekje, as grup profesional apo lobues diplomatik dhe në të njëjtën kohë nuk kemi parë asnjë shfaqje të interesimit zyrtar të shtetit të Kosovës, Qeverisë së Kosovës për anëtarësim në INTERPOL.

Duhet të mos harrojmë se sa herë që Kosova ka nevojë të komunikojë me INTERPOL-in për të përfaqësuar interesin e vet atë duhet ta bëjë, fatkeqësisht, edhe më tutje përmes UNMIK-ut. Ne duhet të jemi të sinqertë, shpesh Rezolutën 1244 e quajmë të

vdekur klinikisht, të skaduar afati apo jo praktike, porse në rastin e INTERPOL-it është Rezoluta 1244, është UNMIK-u që përfaqëson Kosovën. Dhe, kjo jo vetëm që nuk i bën nder Kosovës, porse kjo e dëmton shtetësinë e Kosovës dhe subjektivitetin ndërkombëtar të shtetit tonë.

Besoj se një qasje më profesionale, më gjithëpërfshirëse e të gjitha institucioneve, një prioritet i qartë i Qeverisë së Kosovës do të ndikonte në një grumbullim të përpjekjeve dhe të marrjes së mbështetjes të partnerëve dhe aleatëve perëndimorë për anëtarësimin e Kosovës në INTERPOL.

Fatkeqësisht, kjo po mungon! Dhe, në rastin e Milan Radoicic

dhe të serbëve të tjerë pjesëmarrës në sulmin në Banjskë, është dashur sërish që komunikimi të bëhet përmes UNMIK-ut.

Unë uroj dhe shpresoj që një Qeveri e Kosovës të vendos prioritetin nr. 1 anëtarësimin e Kosovës në INTERPOL për një vit të caktuar dhe gjatë krejt asaj periudhe në nivele jo vetëm politike, por edhe profesionale të llojë e të argumentojë profesionalisht se cilat janë të mirat, përparësitë dhe domosdoshmëritë që Kosova të jetë në INTERPOL.

Tash për tash shohim që përpjekjet e Qeverisë së Kosovës janë zero për anëtarësimin e Kosovës në INTERPOL dhe duket që nuk është fare prioritet!

IKD, FOL dhe INPO: KPK-ja ta shpallë sa më parë konkursin e ri për Kryeprokuror të Shtetit



EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 4 MARS - Organizatat joqeveritare, Instituti i Kosovës për Drejtësi, Lëvizja FOL dhe Iniciativa për Progres, i kanë bërë thirrje Këshillit Prokurorial të Kosovës, që në përputhje me kompetencat që ka, pas mosdekretimit të kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit nga presidentja e Kosovës, të shpallë konkurs të ri për përzgjedhjen e Kryeprokurorit të Shtetit. "Kosova është pa Kryeprokuror të Shtetit që nga prilli i vitit 2022. Tani po bëhen dy vjet qëkur Prokurori i Shtetit funksionon me u. d. të Kryeprokurorit të Shtetit. Me këtë rast, duhet theksuar se nevoja për të pasur Kryeprokuror të Shtetit nuk përjashton nevojën për një

proces transparent dhe meritor për përzgjedhjen e Kryeprokurorit të Shtetit", thuhet në reagimin e këtyre tri organizatave.

Më 17 tetor 2023 presidentja Vjosa Osmani ka njoftuar se nuk e ka dekretuar kandidatin e propozuar nga KPK-ja për Kryeprokuror të Shtetit, duke e kthyer këtë proces në Këshillin Prokurorial të Kosovës. "Fatkeqësisht, kur po bëhen pesë muaj nga nxjerrja e këtij njoftimi nga Presidentja e Republikës së Kosovës, KPK ende nuk ka vepruar në drejtim të zhvillimit të një procesi meritor dhe transparent për përzgjedhjen e kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit. Veprimi i vetëm i tyre ka qenë ripropozimi, pa proces të ri konkurrues, i emrit të njëjtë për

dekretim si Kryeprokuror të Shtetit. Kjo mënyrë e veprimit nga KPK-ja shpërfaq mungesë të vullnetit të tyre për të zhvilluar një proces transparent dhe meritor për përzgjedhjen e Kryeprokurorit të Shtetit, duke abstrahuar moszhvillimin e një procesi meritor, transparent dhe me integritet të pakontestuar", thuhet në këtë reagim.

Sipas IKD-së, FOL-it dhe INPO-s, nëse deri më 17 tetor 2023 KPK-ja nuk ka pasur përgjegjësi për vonesat që janë krijuar në këtë proces për shkak se propozimi ishte te presidentja e Republikës së Kosovës, që nga kjo datë e tutje KPK-ja është institucioni i vetëm përgjegjës pse Kosova nuk ka Kryeprokuror të Shtetit. "Në linjë me rekomandimet e dala nga vendimi i Presidentes së

Republikës së Kosovës, gjetjet e koalicionit të OJQ-ve dhe thirrjeve të partnerëve ndërkombëtarë, KPK duhet ta shpallë konkursin e ri për Kryeprokuror të Shtetit dhe të sigurojë një proces meritor dhe transparent, në mënyrë që emri i Kryeprokurorit të ri të Shtetit të dalë nga një proces me integritet të pakontestuar. Vendimi i presidentes së Republikës së Kosovës konfirmoi gjetjet e koalicionit të OJQ-ve që monitoruan procesin e përzgjedhjes së kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit. Sipas koalicionit të OJQ-ve, procesi i përzgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit nuk ka siguruar meritokraci, objektivitet dhe se kandidatët nuk janë trajtuar në mënyrë të barabartë, çka sipas koalicionit ky proces është

shoqëruar me shkelje të shumta të procedurave", theksohet në këtë reagim të këtyre tri organizatave.

Ndaj këtij procesi kishte reaguar Ambasada Amerikane, ajo Gjermane dhe Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, duke u shprehur të zhgënjyera me këtë proces. Duhet rikujtuar se integriteti i këtij procesi ishte cenuar qysh në fillim, pasi ishte tërhequr nga monitorimi Ambasada Britanike, e cila ishte injoruar për dy muaj nga KPK-ja dhe Kryeprokurori i Shtetit.

Për më tepër edhe Raporti i Progresit për Kosovën për vitin 2022 ka theksuar zhgënjimin e ambasadave dhe të shoqërisë civile për mungesën e drejtësisë, transparencës dhe parimeve të meritës në procesin e zhvilluar nga KPK.

Remitancat në vitin 2023 arritën 1.34 miliard euro

PRISHTINË, 4 MARS - Banka Qendrore e Kosovës ka publikuar statistikën e Bilancit të Pagesave të Kosovës për dhjetor 2023. BQK-ja njofton se bilanci i pagesave deri në fund të dhjetor 2023 u karakterizua me një deficit të llogarisë rrjedhëse në vlerë prej 741.6 milionë eurosh, i cili tregon përmirësim prej

19.1 % krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (917.1 milionë euro ishte deficit deri në dhjetor 2022). "Bilanci tregtar në mallra deri në dhjetor 2023 kishte deficit në vlerë 4.6 miliardë euro, që është për 7.3 % më i lartë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak", thuhet në

njoftimin e BQK-së. Më tej në komunikatë thuhet se remitancat janë kategoria kryesore në kuadër të të ardhurave dytësore, vlera e të cilave deri në dhjetor 2023 shënoi 1,343.4 miliard euro, që paraqet rritje prej 120.5 milionë eurosh ose 10 % krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022.



Rruga Prishtinë - Mitrovicë po bëhet realitet, thonë Kurti dhe Aliu

PRISHTINË, 4 MARS - Kryeministri i vendit, Albin Kurti dhe ministri i infrastrukturës, Liburn Aliu, të hënën kanë përcjellë nga afër punimet e projektit "Zgjerimi i Rrugës Nacionale M2" të rrugës Prishtinë - Mitrovicë. "Filluam javën me vizitë te lokacioni ku po zhvillohen punimet ndërtimore të Rrugës Nacionale N2 Prishtinë - Mitrovicë. Me gjatësi prej 9.78 km, punët ndërtimore përfshijnë zgjerimin e rrugës ekzistuese, rrugë kjo me katër korsi, me dy drejtime të ndara, me korsi secila prej 3.75m gjerësi, po ashtu edhe me korsi ndihmëse në të dyja anët me gjerësi prej 2.0m, si dhe objekte ndihmëse dhe struktura të tjera infrastrukturore si ura. Tani ky projekt është vënë në rrugën e duhur me intensifikimin e punimeve, një investim infrastrukturor me rëndësi madhore për zhvillimin ekonomik të vendit", ka thënë ministri Aliu.

Kryeministri Kurti ka theksuar se nga një rrugë e cila ishte me dy korsi, tash do të kemi rrugë



nacionale me dy drejtime, secila me nga dy korsi, gjithsej katër, plus nga një korsi ndihmëse anash. "Nga projekte me plane

të dobëta, përgatitje të pakta dhe zvarritje të gjata, tani kemi plane të hollësishme, përgatitje të duhura dhe punë të rregullta", ka

pohuar Kurti. Kurti dhe Aliu kanë thënë se kjo rrugë tashmë po bëhet realitet. "Rruga Prishtinë -Mitrovicë po

bëhet", ka thënë Kurti. Vonesa e punimeve në këtë rrugë shpeshherë është kritikuar nga opozita.

Shqipëri - Kosovë, 15 milionë euro për bashkëpunim ndërkufitar për vitet 2021-2027



PRISHTINË, 4 MARS - Rreth 15 milionë euro do të financohen për zbatimin e Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar Shqipëri - Kosovë për vitet 2021-2027.

Nga totali i vlerës së investimit, 9,7 milionë euro do të financohen nëpërmjet buxheteve të dy shteteve, ndërsa 8,4 milionë euro do të jenë kontribut i BE-së në kuadrin e programit IPA III.

Zbatimi i këtij programi, sipas marrëveshjes së miratuar në fillim të muajit shkurt, synon t'i nxisë marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe zhvillimin ekonomik të zonave kufitare përmes turizmit të qëndrueshëm.

45 % e fondeve të IPA III do të alokohen për mbrojtjen e mjedisit. Për disa veprimtari në mjedis në program parashikohet se është parashikuar edhe

kryerja e investimeve për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimaterike dhe për parandalimin dhe menaxhimin e riskut.

Përafërsisht 45 % e fondeve do të alokohen për nxitjen e turizmit dhe trashëgimisë kulturore, duke përfshirë mobilizimin e aktorëve vendorë, si dhe duke mbështetur me produkte dhe shërbime të reja ofertën turistike dhe trashëgiminë kulturore.

BQK-ja me anë të SMS-ve i informon qytetarët mbi qasjen në llogari bankare dhe pranimin e mjeteve në euro

PRISHTINË, 4 MARS - Banka Qendrore e Kosovës, në kuadër të planit për zbatim të lehtësuar të Rregullores për Operacione me Para të Gatshme, ka njoftuar se

përmes operatorëve është duke dërguar SMS te qytetarët për t'i informuar mbi qasjen në llogari bankare dhe për mundësitë e pranimin të mjeteve në llogaritë e tyre në

euro. Po ashtu, BQK-ja bën me dije se të gjithë ata qytetarë që ende nuk kanë llogari mund të hapin një të tillë në njërin nga bankat, sipas Rregullores së

BQK-së për qasje në Llogari Pagese për Shërbime Bazike, që për grupet e cënueshme e të skemave sociale nuk ka tarifë të hapjes e as të mirëmbajtjes nga 1 janari 2024.



Demokracia nuk mund të ndërtohet me hakmarrje



Qershor 1999: Sekretarja amerikane e Shtetit, Madeleine Albright, në Kampin e Stenkovecit afër Shkupit, përkrah shqiptarëve të deportuar nga Kosova, (Foto: EPA/STRINGER)

Nga: Madeleine ALBRIGHT
(pjesë nga vepra Zonja sekretare)
Përktheu: Engjëllushe SHQARRI

Aty nga fundi i korrikut, vizitova Kosovën për herë të parë. Lufta kishte rreth gjashtë javë që kishte mbaruar. Pavarësisht nga meraku ynë, pjesa më e madhe e refugjatëve nuk kishin pritur dhe ishin kthyer. Disa familje ishin të lumtura që ishin bashkuar, kurse disa të tjera kishin zbuluar varre në vende nga më të çuditshmet. Për habinë e disave, UÇK-ja nënshkroi një marrëveshje çmobilizimi me Jamie Rubinin, i cili kishte qenë ndërmjetësuesi i bisedimeve, por megjithatë

vazhdonte të kishte shumë dyshime për qëllimet e këtij grupi. Ashtu siç pritej, kishte disa raste hakmarrjeje, të drejtuara nga shqiptarët etnikë kundër serbëve, shumë prej të cilëve u larguan në Serbinë mëmë. Kosova e mëparshme ishte shkatërruar, kurse procesi i rindërtimit pothuajse nuk kishte nisur. Kur isha në Prishtinë, fola para një turme të madhe të mbledhur në sheshin qendror të qytetit. Për shkak të gjithë atyre çatëve dhe dritareve, ishte vështirë të patrolloje. Dhe, ndërsa prisja në shtabin e OKB-së para se të flisja, dëgjuam një të shtënë arme, por askush nuk e dinte nga erdhi. Për të shmangur rezikun, më çuan

me një mikrobus në ato pak metra që nga dera e ndërtesës deri te podiumi që kishin ngritur para turmës. Pastaj mikrobusi ndaloi pas shpinës sime me derë të hapur, që, në rast se ndodhte gjë, të bija drejt e në të. Turma, e zmadhuar prej refugjatëve të kthyer, ishte veshur me kostume kombëtare shqiptare dhe me bluza të Chicago Bulls-ave. Ndërsa prisja të mbaronin duartrokitjet, studioja njerëzit që kisha përpara. M'u kujtuan ata që kisha parë kohët e fundit në kampet e refugjatëve, si dhe të tjerë në gazeta dhe në televizor: fytyra të lodhura nga vuajtjet, të shtrembëruara nga frika ose

gjithë ankt, ndërsa familjet e tyre kërkonin të dashurit që ishin zhdukur. Tani po ato fytyra buzëqeshnin. I thashë turmës: "Kam shumë kohë që mendoj për ju dhe për vuajtjet që keni kaluar. Sot duhet të betohemi që kurrë më të mos vijmë natën njerëz me armë dhe kurrë më të mos ketë masakra në Kosovë". Fjalët e mia u pritën me brohoritje. "Duhet të mbështetim Gjykatën për Krimet e Luftës, sepse ata që janë akuzuar për spastrime etnike dhe vrasje, duhet të japin llogari, ndërsa Sllobodan Millosheviqi duhet të përgjigjet për krimet e tij". Turma brohoriti edhe më fort. Pastaj thashë: "Demokracia nuk mund

të ndërtohet me hakmarrje. Në qoftë se duam të kemi fitore të vërtetë në Kosovë, kjo nuk mund të jetë fitorja e shqiptarëve kundër serbëve ose e NATO-s kundër serbëve. Duhet të jetë fitorja e atyre që besojnë te të drejtat e individit, ndaj atyre që nuk besojnë. Ndryshe nuk është fitore. Është vetëm zëvendësimi i një lloj represioni me një tjetër". Turma ra në qetësi. Mund të dëgjohej edhe zhurma e një gjilpëre. Sigurisht, nuk prisja që plagët e trupit dhe të mendjes së Kosovës të shëroheshin aq lehtë. Pasionet e luftës vazhdonin të ishin të mëdha. Por, doja të përçoja një mesazh të vështirë.

Zbulohen 11 monedha ari të kohës së Aleksandrit të Madh

Një zbulim i rëndësishëm është bërë së fundmi në pjesën e vjetër të qytetit të Chania, në kodrën Kastel në Kretë, shkruan focus.it. Gërmimet arkeologjike kanë zbuluar një grumbull monedhash, 11 prej tyre ari. Ato ndoshta i përkisnin një mercenari në shërbim të një prej pasardhësve të Aleksandrit të Madh. Elementi më interesant ishte zbulimi i "Golden Staters", monedha ari, secila me vlerë rreth një muaj pagese të një mercenari të atëhershëm. Përveç monedhave vendase u gjetën edhe disa të vendeve të

tjera, duke filluar nga një monedhë nga Kirenia, 15 nga Olimpia dhe një monedhë e vogël vendase, por jo më pak e rëndësishme nga pikëpamja arkeologjike. Meqenëse monedhat ishin vendosur të gjitha së bashku, personi që i posedonte ishte pronari i një thesari të vogël, sipas studiuesve. Siç u përmend më parë, hipoteza flet për mundësinë që thesari i përkiste një mercenari në shërbim të njërit prej mbretërive që pasuan atë të Aleksandrit të Madh,

përkatesisht dinastisë "Ptolemeike" (dinastia helenistike që sundoi mbretërinë e Egjiptit nga viti 305 p.e.s. 30 p.e.s.) ose Seleucidët (dinastia helenistike që mbretëroi në pjesën lindore të dominimeve të Aleksandrit të Madh pas vdekjes së tij). "Të 37 monedhat u gjetën brenda një vazoje të vogël terrakote dhe duket se ato me vlerë më të vogël ishin vendosur mbi ato të arit, gati për t'i fshehur ato", shpjegon Maria Andreadak Vlazaki, drejtoreshë e gërmimeve në kodrën Kastelli.



EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
 Enveri
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com



Drilon Hazrollaj sërish fiton çmimin ‘Ylli i javës’ në Superligë

MALISHEVË, 4 MARS - Futbollisti Drilon Hazrollaj po vazhdon formën e mirë në Superligë, kurse këtë xhiro ka qenë vendimtar në fitoren e Malishevës ndaj Gjilanit duke realizuar tre golat e fitores

ndaj Gjilanit (2-3). Vlerësimi i më të mirit të javës është bërë nga Komisioni i Veteranëve të Futbollit në përbërje: Enes Shosholli, Lulzim Berisha dhe Bujar Guta. Ky është çmimi i tretë për Hazrollajn në këtë

edicion dhe i dyti radhazi. Futbollisti i ri i Malishevës, i cili po kalon në formë të jashtëzakonshme, u shfaq i lumtur për vlerësimin si më i miri i javës. “Ndihej i lumtur. Ky është çmimi i tretë

për mua dhe është motivim shtesë. Uroj që edhe në vazhdim të kampionatit të kemi një ecuri pozitive si ekip dhe t’i arrijmë objektivat”, ka thënë Hazrollaj për faqen zyrtare të FFK-së.



Kosova U18, pas kualifikimit historik, ka synime të mëdha në Botëror

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 4 MARS - Përfaqësuesja U18 e Kosovës në hendboll, pas suksesit historik që e arriti duke u kualifikuar në Kampionatin Botëror, të hënën është rikthyer në Kosovë. Pas këtij suksesi historik është mbajtur konferencë për medie në lokalet e Federatës së Hendbollit të Kosovës.

Numri një i hendbollit të Kosovës, Eugen Saraçini, e ka vlerësuar historik kualifikimin në Botërorin që do të mbahet në muajin gusht. “Me krenari e themi se ky është një moment historik për sportin e Kosovës. Janë kualifikuar në Kampionatin Botëror që do të mbahet në Kinë në muajin gusht dhe mund të them se vajzat tona na kanë bërë krenarë me këtë sukses të jashtëzakonshëm të arritur. Meritore për këtë sukses janë të gjitha hallkat dhe, po ashtu, në arenën ndërkombëtare hendbolli



është duke ecur mirë, gjë që na bën krenarë të gjithëve”, ka thënë Saraçini. “Vitin e kaluar ka filluar ky udhëtim, pasi morën pjesë në IHF Trophy në zonën evropiane

dhe tani kulmoi me triumf. Ky sukses besoj se do të jetë një motiv i madh jo vetëm për hendbollin, por edhe për sportet e tjera, që të jenë konkurrues për

të arritur suksese. Ne mendojmë dhe synojmë që në të ardhmen të jemi shumë më lart”, ka shtuar Saraçini.

Edhe trajneri Mitat Ferati ka

shprehur krenari me këtë moment historik, i cili, sipas tij, erdhi falë angazhimit të gjithëve. “Kemi një ekip me lojtare nga Zvicra, Gjermania dhe Kosova, ndërsa vajzat ishin fantastike. E kemi pasur një fazë të vështirë me kundërshtarë të fortë. Nuk ishte aspak lehtë. Mirëpo angazhimi i vashave në secilën ndeshje ka bërë që të arrijmë këtë sukses të madh, kualifikimin në Botërorin U18. Çelësi i këtij suksesi është talenti që e posedojnë këto vasha pasi kanë dhënë më të mirën nga vetja. Deri tash kemi bërë paraqitje të mira dhe e kemi dëshmuar këtë, por ende nuk kemi hasur në ekipe që na presin në Kinë, ku do të mbahet Botërori. Krahas punës, edhe disiplina e ka sjellë këtë sukses”, ka thënë Ferati. Hendbollistet Arona Krasniqi dhe Sara Gjergaj e kanë vlerësuar këtë sukses si arritje të madhe, njëherësh kanë premtuar angazhim maksimal në Botëror për të pasur suksese të reja.

Final 8 i Ligës Unike të meshkujve zhvillohet në Vlorë



VLORE, 4 MARS - Në fund të muajit mars do të zhvillohet Final 8 i Ligës Unike të meshkujve. Të hënën është zhvilluar konferenca për medie, që ishte shumë e rëndësishme para fillimit të kësaj ngjarje. U finalizua marrëveshja trepalëshe në mes të presidentit të Federatës Shqiptare të

Basketbollit, Avni Ponari, Hajri Elezi, president i Lajthiza Invest dhe nënkryetarit të Bashkisë Vlorë, Klevis Kaso.

Në këtë aktivitet, që do të zhvillohet në Vlorë, sponsor gjeneral do të jetë “Lajthiza”, duke ofruar mbështetje të jashtëzakonshme për këtë

eveniment sportiv. Ky aktivitet merr titullin Liga Unike Lajthiza. Ndashjet do të zhvillohen me 27-31 mars në palestrën “Flamurtari” në Vlorë. Ekipet nga Shqipëria do të jenë Tirana, Kamza, Besëlidhja dhe Teuta, ndërsa ekipet nga Kosova: Peja, Sigal Prishtina, Trepça, Golden Eagle Ylli.

Thomas i Pejës, MVP i javës në Superligë

PEJË, 4 MARS - Elita e basketbollit u rikthye në aksion pas Final 8 Kupës dhe ndeshjeve të Kosovës. Peja shënoi fitore ndaj Vëllaznimit në Gjakovë. Më i miri ishte Larry Thomas me 25 pikë, pesë kërcime dhe gjashtë asistime, si dhe tre topa të vjedhur. Ai u ndihmua nga Justin Davis, i cili po vazhdon

me formë të lartë me 17 pikë, katër kërcime dhe pesë asistime. Fitore si mysafir shënoi edhe Golden Eagle Ylli ndaj Bashkimit në Prizren. Edhe kësaj radhe u dallua organizatori Alonso Verge Jr me 26 pikë, tri kërcime dhe shtatë asistime. Proton Cable Prizreni shënoi fitore të rëndësishme ndaj Sigal

Prishtinës, ku u dallua qendra e Kosovës, Urim Zenelaj me 23 pikë e nëntë kërcime dhe një asistim. Trepça e para shënoi fitore të pritur ndaj Istogut të fundit, ku indeksin më të lartë e kishte Devonte Upson 37 apo ndeshjen e mbylli me 23 pikë, nëntë kërcime dhe katër asistime.



Rashica: Keqardhje që nuk arritëm fitoren në derbi

STAMBOLL, 4 MARS - Beshiktashi zhvilloi një paraqitje spektakolare në derbin e madh të Stambollit ndaj rivalit historik Galatasarayt, por rezultati nuk ishte pasqyrë e lojës, me vendasit që u

mundën 0-1. Futbollisti shqiptar Milot Rashica pas ndeshjes u duk shumë i trishtuar për humbjen ndaj Galatasarayt e më të tej u shpreh se ai dhe shokët e skuadrës ndihen keq për faktin

që dolën pa pikë nga sfida me kryesuesit e kampionatit. "Jam vërtet i trishtuar. Në përgjithësi mund të them se luajtëm ndeshjen më të mirë të sezonit. Qarkulluam topin, krijuam rastet tona, por nuk

arritëm të shënonim gol. Na mungoi finalizimi teksa pësuam një gol të shpifur. Fatkeqësisht shënuam autogol. Jam i trishtuar që nuk arritëm ta fitonim derbin", ka thënë Rashica.



Lideri sfidohet nga kampioni

TIRANË, 4 MARS - Të martën zhvillohet xhironja e shtatë në Liga Unike Femrat. Të gjitha ndeshjet zhvillohen nga ora 17:00. Në Liga Unike Femrat zhvillohen dhjetë xhiro, më pas katër skuadrat e para do të luajnë në "play-off". Bashkimi është lider me gjashtë fitore në gjashtë ndeshje, njëherësh skuadra e vetme pa humbje, kurse këtë xhiro do të sfidohet nga Partizani, që është kampion aktual, por këtë edicion nuk e ka nisur mbarë me një fitore e pesë humbje.



Të martën në kryeqytetin e Kosovës do të luhet ndeshja mes skuadrave Penzës dhe Prishtinës. Skuadra pejana ka dy fitore e katër humbje, kurse ajo prishtinase ka pesë fitore e një humbje. Ndërkohë, në

kryeqytetin e Shqipërisë zhvillohet përballja në mes të Tiranës dhe Flamurtarit, ku të dyja skuadrat kanë nga dy fitore e katër humbje dhe do të bëjnë çmos për fitore, që të jenë në fazën e "play-off"-it.

LIGA UNIKE FEMRAT - JAVA 7

Të martën takohen:

17:00 Penza - Prishtina
17:00 Tirana - Flamurtari
17:00 Bashkimi - Partizani

Golden State turpërohet nga Bostoni, Oklahoma merr kreun e renditjes në Perëndim

BOSTON, 4 MARS - Skuadra e Golden States u mund thellë me shifrat 88-140 nga Bostoni, që kryeson jo vetëm renditjen në Konferencën e Lindjes, por edhe në NBA këtë sezon. Fitore e thellë, me 52 pikë për Celticsin, ku dyshja Brown - Tatum realizuan 56 pikë së bashku. Oklahoma merr kreun e klasifikimit në Perëndim pas fitores me rezultat 118-110 në fushën e Phoenixit. Të gjithë titullarët e ekipit mik realizuan mbi 10 pikë, ku u dallua Alexander Shai, autor i 35 pikëve. Humbet Minnesota, që u mund në sekondat e fundit nga Clippersat (89-88). Leonardo me 32 pikë ishte lider për Clippersin, duke i bërë të pavlefshme 27 pikët e Edwardsit për vendasit. Fitore të



rëndësishme për "play-off"-in korri Philadelphia, që mundi Dallasin (120-116), ndeshje ku u dalluan Harrisit me 28 pikë, Maxey

me 24 e Oubre me 21 pikë. Donçiqi realizoi një "triple double" për Dallasin (38 pikë, 11 rebounde, 10 asistime), por që s'mjaftuan.

REZULTATET

Dallas - Philadelphia	116-120
Minnesota - Clippers	88-89
Boston - Golden State	140-88
Toronto - Charlotte	111-106
Orlando - Detroit	113-91
San Antonio - Indiana	117-105
Cleveland - New York	98-107
Phoenix - Oklahoma	110-118

SHKURT

Guardiola: Fodeni është lojtari më i mirë në Premierë Ligë

Phil Fodeni ka shkëlqyer në fitoren e Manchester Cityt ndaj Manchester Unitedit, duke realizuar dy gola në fitoren 3-1. Trajneri Pep Guardiola ka thënë se Fodeni është lojtari më i mirë në Premierë Ligë. "Gjithmonë ka qenë një futbollist i talentuar, por tani është më i pjekur dhe arrin ta lexojë më mirë lojën, sidomos në aspektin mbrojtës. Ai mund të luajë kudo. Çfarë të them, Phil është lojtari më i mirë në Premierë Ligë për momentin. I mrekullueshëm. Ai e dashuron futbollin, jeton për futbollin. Më dha kënaqësi të madhe me dy golat që realizoi. Është gëzim i madh ta shohësh duke luajtur. Ka edhe një etikë punë të jashtëzakonshme", ka thënë Guardiola.

Musiala refuzon rinovimin e kontratës me Bayernin

Ylli i Kombëtares së Gjermanisë, Jamal Musiala, ka kontratë me Bayern Munchenin deri në vitin 2026, por ai ka refuzuar rinovimin e saj për faktin se synon transferimin në Premierë Ligë, shkruan "Daily Star". Të interesuara për shërbimet e tij janë dy klubet angleze, Manchester City dhe Chelsea. Pavarësisht se fiton 8 milionë euro në vit te Bayerni, një nga më të paguarit në klub, Musiala mund të marrë menjëherë pagë më të lartë në një numër klubesh të ndryshme evropiane. Megjithatë, siç raportohet nga "Sky Germany", kjo nuk është arsyeja e vetme për të cilën duhet të shqetësohet Bayerni.

Ballack këshillon Alonson: Qëndro në Leverkusen

Ish-ikona e Bayer Leverkusenis dhe Bayern Munchenit, Michael Ballack, e ka këshilluar trajnerin aktual të Leverkusenis, Xabi Alonso, të qëndrojë në skuadrën aktuale edhe pas përfundimit të këtij edicioni. "Xabi i ka dhënë mentalitetin e duhur Leverkusenis, teksa e ka ngritur në nivel të tillë. Diferenca prej 10 pikësh nga Bayerni ndjekës s'është e rastësishme, demonstroi punën e grupit në krye me një trajner të jashtëzakonshëm. Nëse ndihet i lumtur dhe i kënaqur me gjithçka në ekipin ku po drejton momentalisht, nuk shoh arsye përse ai të ndryshojë ambient", ka thënë Ballack.

Xavi: Nuk luajtëm mirë

Barcelona dështoi t'i marrë tri pikët e plota në ndeshjen ndaj Athletic Bilbao (0-0). Pas ndeshjes, trajneri Xavi Hernandez analizoi përballjen e fortë me baskët, duke pranuar se skuadra e tij nuk luajti mirë. "Mendoj se nuk luajtëm mirë, nuk sulmuam siç duhet. Duhet të kishim bërë një hap përpara. Jemi të trishtuar. Nuk kemi dhënë versionin më të mirë. Duhet të bënim më tepër. Është një mundësi e humbur për t'u afruar me vendin e parë. Skuadra mund të kishte bërë më shumë. E kishim të vështirë të gjenim hapësira. Duhet të përmirësohemi, por na vjen keq që e humbëm mundësinë për t'u afruar me Realin", ka thënë Xavi.

Jos Verstappen kundër drejtuesve: Ka tension, situata mund të shpërthejë

Kampionati Botëror i Formulës 1 ngriti siparin fundjavën që lamë pas me garën e parë, e vlefshme për çmimin e madh të Bahreinit. Red Bulli dhe Max Verstappen u rikonfirmuan si pretendentët absolutë të këtij edicioni. Por, në

skuadrën austriake kanë filluar problemet e para të brendshme, që kanë zanafillën nga hetimi që këta te fundit i bënë drejtuesit kryesor, Christian Horner. Së fundmi, ish-piloti holandez, njëkohësisht babai i Max

Verstappenit, Jos Verstappen, "turbulloi" ambientin me deklaratën e tij të fundit në drejtim të Hornerit: "Ka një tension në skuadër për sa kohë Horneri vazhdon të jetë në pozicionin e drejtuesit të Red

Bullit. Harmonia rrezikon të shkatërrohet. Horneri luan rolin e viktimës, por është ai që po shkakton problem me qëndrimin e tij. Kam frikë se situata brenda grupit mund të shpërthejë". Gjatë karrierës së tij,

52-vjeçari ka qenë aktiv në Formula 1 për 6 vjet, por asnjëherë nuk ka pasur suksesin që i biri i tij Max Verstappen po arrin në garat e shpejtësisë. Deri tani holandezi ka fituar tre tituj radhazi.

Drejtoria e Gjinnazit "Gjon Buzuku" në Prizren
Nr. prot: 368 datë 04.03.2024
Prizren
Bazuar në nenin 11, të Udhëzimit Administrativ – Aktivitetet jashtëshkollore nr. 02/2016 dhe në vendim nr. Prot: 353 të datës 01.03.2024, të KDSH-së, Gjinnazit "Gjon Buzuku" në Prizren, shpall:

Ftesë për ofertë

Për ekskursion të maturantëve të Gjinnazit "Gjon Buzuku" në Prizren
Ftojme ofertuesit e kualifikuar (Agjensitë turistike organizatore të udhëtimit) që të paraqesin ofertat e tyre në zarf të mbyllur, për ekskursionin e maturantëve të Gjinnazit "Gjon Buzuku" nga Prizreni për në Republikën e Shqipërisë më datë 07.05.2024 deri më 11.05.2024.

Paraqitësit në tender duhet t'i plotësojnë këto kushte:

Kriteret e përgjithshme:

- Certifikatën e biznesit me informata për biznesin,
- Vërtetimin e Administratës Tatimore për tremujorin e fundit të vitit fiskal
- Vërtetimin për pagesën e taksave komunale për vitin 2023
- Licencën e transportit ndërkombëtar "D"
- Referencat rreth organizimit të ekskursioneve me maturantë për vitin 2023
- Fotokopjet e librezave të autobusëve që janë të regjistruar sipas procedurave ligjore dhe kontrolli teknik
- Kopjen e sigurimit të autobusëve, patentshoferëve të vozitësve dhe certifikata e kompetencës profesionale CPC
- Certifikatat mjeksore për vozitësit
- Autobusët të jenë në pronësi, komfor me klimë dhe në numër të mjaftueshëm për mbi 350 vende.
- Kompania të sigurojë mjekun (certifikatë pune dhe diplomë të mjekut).
- Licencën e agjencionit të akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve
- Dëshmi për hotelin e ofruar në Durrës për datat 07.05.2024- 11.05.2024.
- Të prezantohet ambienti (komoditeti) së paku me foto i Hotelit (në CD) nr.telefonit i pronarit dhe adresa.
- Hoteli të posedoj mbi 350 shtretër. Të posedoj banjo dhe ujë të mjaftueshëm.
- Sistemit i nxënësve në dhoma të jetë jo më shumë se katër nxënës.
- Të prezantohet menyuja e ushqimit dhe pijeve për tri racione ditore për pesë ditë qëndrimi, dhe sipas kërkesave të ofrohet ushqim në orar për nxënësit që axherojnë.
- Gjatë vizitave nëpër monumente të sigurohet shujta dhe pagesa hyrëse nëpër monumente sipas itinerarit të përcaktuar nga KDSH.
- Agjensioni të ofrojë dëshmi për qarkullimin financiar nga banka për tre vitet e fundit (2021, 2022 dhe 2023) së paku 250 000 euro.
- Hoteli të posedoj sallë për argëtim për nxënës dhe të mos shërbehen apo lejoj shitjen dhe përdorimin e pijeve alkoolike në tërë hapësirën e hotelit.
- Licencën e sallës për argëtim për së paku 350 nxënës.
- Oferta për nxënës të liruar nga pagesa.
- Kompania Turistike të mos ketë asnjë ankesë nga KN, nga vitet e kaluara.
- Vërtetim (certifikatë) mbi qëndrueshmërinë e Hotelit pas termetit të lëshuar nga organet kompetente.
- Të gjithë dokumentacionet të jenë të noterizuara, ose të vërtetuara në Komunë

Vërejtje: Kompania Turistike fituese në përfundim të eskursionit duhet t'i sigurojë nënshkrimet nga: Drejtori i shkollës, përfaqësuesi i Këshillit të prindërve si dhe nga përfaqësuesi i Këshillit të nxënësve, për përmbushjen e kushteve të përcaktuara sipas kriterëve të lartëcekura dhe ky dokument të dorëzohet në DKA.

P.s. Lartësia e pagesës 145 euro

Ofertuesit e interesuar aplikacionet me itinerarin e udhëtimit mund t'i marrin në administratën e shkollës dhe të kompletuara me dokumentacionin e kërkuar të dorëzohen në Drejtorinë e Arsimit në Prizren.

Afati i paraqitjes në tender është 7 ditë nga dita e publikimit në gazetë.

Hapja e ofertave bëhet nga komisioni sipas UA.02/2016 më datë 12.03.2024.

Pas hapjes së ofertave, Komisioni do të verifikoj dokumentacionin dhe kushtet e ofruara nga kompanitë, ku dhe do të bëhet vlerësimi.

Drejtoria e shkollës mban të drejtën për anulimin e ofertës.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Besarta's Studio" SH.P.K. me seli në Gjakovë, me pronar Besarta Gashi, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812098590 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavajte se svi klienti da drustvo sa "Besarta's Studio" D.O.O. Djakovica, sa vlasnikom Besarta Gashi, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812098590 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavlivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "Besarta's Studio" L.L.C. with headquarters Gjakovë, with owner Besarta Gashi, has come to the decision to quit its business: 812098590 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Valdrin Makolli shpall të pavlefshme dëftesat si dhe diplomën e shkollës së mesme "Shtjefën Gjeqovi" Prishtinë.

- Shaip Arifi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të lartë "Arkitekt Sinani" ish shkolla e mesme "Boris Kidric".

- Ragip Aliu shpall të pavlefshme 4 dëftesa dhe diplomën Q.K "11 Marsi" Prizren.

- Qendrim Avdyli shpall të pavlefshme 3 dëftesa dhe diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren.

- Jeton Berisha shpall të pavlefshme dëftesën e kl 11 të shkollës së mesme "Hivzi Sylejmani" Fushë Kosovë.

- Aeroporti Ndërkombëtare i Prishtinës-Kontrolli Ajror "Adem Jashari", Sh.A, shpall të humbur certifikatën e biznesit me numër: 70280980, të lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.

- Marjana Nikolla nga Dobli Bare KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f. "Dëshmorët Lleshi" Dobli Bare KK Gjakovë nga kl. I-VIII.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
®
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

